



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/108

Datë: 04.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 04 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Miratohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet; 106 dhe 107 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/108
Datë: 04.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 04 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Autorizohet Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave të ndajë mjetet nga "Fondi për punësim me Bankën Botërore" në shumë prej 8 (tetë) milionë euro në ministritë e linjës, pas harmonizimit me Bankën Botërore.
2. "Fondi për punësim me Bankën Botërore" është pjesë e Tabelës 1. të Ligjit Nr. 03/L-177, për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2010.
3. Pas transferimit të mjeteve nga "Fondi për punësim me Bankën Botërore" në ministritë e linjës, këto fonde do të jenë pjesë e tabelave të buxhetit 3.1 dhe 3.2 dhe tabelave tjera përcjellëse të buxhetit për vitin 2010.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Kuvendit të Kosovës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/108


Datë: 04.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 04 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Zotohet ndarja e mjeteve financiare për komunat Shtërpcë dhe Graçanicë në shumën prej 2.100.000 (dy milionë e njëqindmijë) euro.
2. Për Komunën e Shtërpcës zotohen mjete financiare për projektet:
 - 2.1 500.000 (pesëqind mijë) euro, "Ndërtimi i shtëpive të familjeve që janë të strehuara në objektet hoteliere";
 - 2.2 500.000 (pesëqind mijë) euro "projekte të infrastrukturës"; dhe
 - 2.3 300.000 (treqind mijë) euro, "Borxhet e vjetra".
3. Për Komunën e Graçanicës zotohen mjete financiare për projektet:
 - 3.1 300.000 (treqind mijë) euro, "Ndërtimi i Spitalit".
 - 3.2 350.000 (treqindpesëdhjetë mijë) euro, "Projekte të infrastrukturës".
 - 3.3 150.000 (njëqindpesëdhjetë mijë) euro, "Rregullimi i shtratit të lumit në Graçanicë"
4. Mjetet të sigurohen nga programi: " Shpenzimet e paparashikuara".
5. Mjetet të barten në buxhetin e komunave të cekura në pikën 1. të këtij vendimi sipas dinamikës së pagesave të projekteve.

6. Ministrinë e linjës menjëherë të rezervojnë mjete financiare për të kontribuar në plotësimin e programit: Shpenzimet e paparashikuara, kategoria ekonomike: shpenzimet kapitale në shumën prej 2.100.000 (dy milionë e njëqindmijë) euro me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2010, si vijon:
- 7.1 Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit - 700.000 (shtatëqind mijë) euro;
 - 7.2 Ministria e Shëndetësisë - 300.000 (treqind mijë) euro;
 - 7.3 Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - 400.000 (katërqind mijë) euro;
 - 7.4 Ministria e Administratës Publike - 300.000 (treqind mijë) euro;
 - 7.5 Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal - 150.000 (njëqindpesëdhjetë mijë) euro;
 - 7.6 Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - 150.000 (njëqindpesëdhjetë mijë) euro;
 - 7.7 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - 100.000 (njëqindmijë) euro.
7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/108

Datë: 04.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 57 të Ligjit nr. 2004/48 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 04 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Për anëtarë të Bordit të Pavarur për Rishqyrtimin e Ankesave i propozohen Kuvendit të Kosovës këta kandidatë:
 - 1.1 Naile Alaj
 - 1.2 Sylë Hoxhaj
 - 1.3 Islam Revuqi
 - 1.4 Faik Qollaku
 - 1.5 Luigj Gojani
 - 1.6 Bajram Fusha
 - 1.7 Naser Grajqevci
 - 1.8 Ismail Kovaç
 - 1.9 Predrag Rashiq
2. Obligohet Sekretari i Përhershëm i Zyrës së Kryeministrit që vendimin së bashku me biografite e kandidatëve t'ia përcjellë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/108

Datë: 04.02.2010

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të nenit 4 paragrafi (3) të Rregullores së Punës së Qeverisë së Kosovës nr. 01/2007, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 04 shkurt 2010, mori

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 9.500 (nëntëmijepesëqind) euro, ndihmë familjes së Naser Hajdarajt, nga fshati Klladërnice, komuna e Skenderajt.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga rezervat e Qeverisë dhe barten në llogarinë bankare të z. Naser Hajdaraj Nr. : 1160645713000148, ProCredit Bank, Skenderaj.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përhershëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë